



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Planuar / Doretina Pranimit / Pristalo Recieved / Dostavio	08.09	3	2023
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	SHKONJACKU	6032/2023	1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.962/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.962/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, me adresë rr “_____” Komuna Suharekës, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.962/2023 e datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vërejtja me shkrim me numër protokolli 0760/23 e datës 07.07.2023 e shqiptuar ndaj ankuesit, nga Mbikëqyrësi i Qendrës së Paraburgimit në Prizren, në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar (Personel Korrektues) të datës 02.07.2018 në pozitën e punës “Zyrtar Korrektues” në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Me datën 07.07.2023 me numër protokolli 0760/23, Mbikëqyrësi në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë i ka shqiptuar vërejtjen me shkrim ankuesit me arsyetimin se: *Bazuar në nenin 45 paragrafi 1 pika 1.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe pas administrimit të të gjitha provave dhe të gjeturave si: informatën e zyrtarit korrektues A.G. të datës 22.05.2023, informatën e mbikëqyrësit F.Xh. të datës 22.05.2023, informatën e mbikëqyrësit të Lartë Sh.P. të datës 22.05.2023, informatën e zyrtarit të financave E.B. të datës 26.05.2023, deklaratën e punonjësit të kompanisë “Apetit Group” V.V. të datës 29.05.2023, deklaratën e zyrtarit korrektues M.D. të datës 22.05.2023, intervistën e zyrtarit korrektues A.G. të datës*

25.05.2023, për arsye se me datën 22.05.2023 zyrtari korrektues Arben Gashi derisa ishte me detyrë i caktuar tek porta kryesore, nga neglizhenca lejon që punonjësi i kompanisë "Apetit Grup" V.V. të hyj me telefon mobil në pjesën ku është e ndaluar bartja e telefonit mobil duke qenë se në atë pjesë kanë qasje të burgosurit dhe ekziston mundësia e keqpërdorimit të telefonit. Gjatë shkarkimit të mallit, mbikëqyrësi F.Xh. e vëren telefonin mobil tek punonjësi i kompanisë në fjalë dhe të njëjtin e urdhëron që menjëherë ta dorëzojë në kasetën e dedikuar për telefona mobil tek porta hyrëse. Me këtë veprim zyrtari korrektues Arben Gashi ka bërë shkelje të lehtë disiplinore të përcaktuar sipas nenit 46 paragrafi 2 pika 2.2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik e lidhur me Instruksionet e Drejtorit në Q.P. Prizren referenca nr.04/2022.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen me numër protokollit 0760/23 të datës 07.07.2023, të shqiptuar nga ana e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të tij, me datën 12.07.2023 përmes postës, ka parashtruar ankesë e cila në Këshill është pranuar me datë 14.07.2023 me numër protokollit 5213/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave ligjore, vërtetimit të gabuar, jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim i gabuar i ligjit material, i njëjti po ashtu kërkon që ti aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të anulohet masa disiplinore e shqiptuar si vërejtje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.07.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 21.07.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 28.08.2023 ka nxjerr Vendim VK/2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës A.nr.962/2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokollit 5213/2023 të datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtja me shkrim me numër protokollit 0760/23 e datës 07.07.2023; Pliko me numër R5201704 i datës 12.07.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.07.2023; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 20.07.2023; Përgjigje në ankesë e datës 21.07.2023; E-mail nga K.S. për C.Z. i datës 21.07.2023; Shkresat e lëndës me numër protokollit 965 i datës 21.07.2023; Kontratë Pune për Kohë të Pacaktuar (Personel Korrektues) i A.G. i datës 02.07.2018; Përshkrimi i Detyrave të Punës për pozitën e punës "Zyrtar Korrektues" në Shërbimin Korrektues të Kosovës i datës 03.01.2020; E-mail nga A.M. për XH.I. etj. i datës 21.07.2023; E-mail nga M.A. për A.M. i datës 21.07.2023; Deklaratë e datës 29.05.2023; Informatë me numër protokollit 630/23 i datës 22.05.2023; Informatë me numër protokollit 627/23 i datës 22.05.2023; Informatë me numër protokollit 632/23 i datës 22.05.2023; Informatë e datës 26.05.2023; Informatë me numër protokollit 631/23 i datës 22.05.2023; Intervista e A.G. i datës 25.05.2023; Intervista e A.G. i datës 25.05.2023; Vendim për fillimin e hetimeve i datës 23.05.2023; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 07.09.2023; E-mail nga A.P. për D.B. i datës 07.09.2023; E-mail nga printer.shkk@rks-gov.net për A.P. i datës 07.09.2023; Shkresë Instruksionet e Drejtorit për stafin me numër referenca nr.04/2022 të datës 14.03.2022; Vendim me numër protokollit 5839/2023 i datës 28.08.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Arben Gashi, është e pabazuar, sepse:

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua fillimisht dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 45 me të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46 me të cilin është përcaktuar se: "... Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta. 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. 4. Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar.

Nenit 47 paragrafit 1 me të cilin në mënyrë taksative janë përcaktuar masat disiplinore: "Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil".

Nenit 48 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqyrtimin e masave disiplinore "1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil.

Nenit 50 paragrafi 1, i cili ka përcaktuar se: "1.Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi Arben Gashi sipas të gjeturave në provat e lëndës të dërguara nga organi i punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, bazuar në: informatën e zyrtarit korrektues A.G. të datës 22.05.2023, informatën e mbikëqyrësit F.Xh. të datës 22.05.2023, informatën e mbikëqyrësit të Lartë Sh.P. të datës 22.05.2023, informatën e zyrtarit të financave E.B. të datës 26.05.2023, deklaratën e punonjësit të kompanisë "Apetit Grup" V.V. të datës 29.05.2023, deklaratën e zyrtarit korrektues M.D. të datës 22.05.2023, intervistën e zyrtarit korrektues A.G. të datës 25.05.2023, për arsye se me datën 22.05.2023 zyrtari korrektues [redacted] derisa ishte me detyrë i caktuar tek porta kryesore, nga neglizhenca lejon që punonjësi i kompanisë "Apetit Grup" V.V. të hyj me telefon mobil në pjesën ku është e ndaluar bartja e telefonit mobil duke qenë se në atë pjesë kanë qasje të burgosurit dhe ekziston mundësia e keqpërdorimit të telefonit. Gjatë shkarkimit të mallit, mbikëqyrësi F.Xh. e vëren telefonin mobil tek punonjësi i kompanisë në fjalë dhe të njëjtin e urdhëron që menjëherë ta dorëzojë në kasetën e dedikuar për telefona mobil tek porta hyrëse.

Kolegji ka analizuar Deklaratën e datës 29.05.2023 të V.V. të furnitorit "Apetit Grup" ku deklaroi se citoj: Unë jam V.V. furnitor i "Apetit Grup" me datë 22.05.2023 isha duke furnizuar Burgun e Prizrenit, Of. Që punoj te porta më tha që vendosi në kaseten, telefonin, kuletën, i kom lan kaset të gjithë po telefonin tjetër u kanë në kerr, telefonin që e kom pas në kerr e kom shti në xhep. E dorëzova mallin kuzhin telefoni më cingroj e vërejt mb. F. dhe më tha dërgo telefonin kaset une ashtu veprova, i kërkova falje dhe e vendosa telefonin në kaset.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi [redacted] bazuar në intervistën e datës 25.05.2023 ka deklaruar se citoj: Edhe pse nuk jam me shëndet mirë, jam duke u munduar maksimalisht të respektoj procedurat jo vetëm aty ku jam i caktuar por në çdo vend pune, jam munduar dhe do të mundohem edhe në të ardhmen. Kërkoj falje dhe po më vjen shumë keq që ka ndodhur ky rast por që ndodhi dhe besoj që nuk do të ndodhë diçka e tillë në të ardhmen dhe ju betohem se nuk kam patur asnjë qëllim të keq sepse nuk i përkas asaj kategorie njerëzish. Kolegji ka konstatuar se ankuesi rrjedhimisht në bazë të intervistes së datës 25.05.2023 e ka pranuar fajësinë e tij dhe i njëjti është përgjegjës për lëshimin e bërë nga ana e tij dhe se pretendimet ankimore të tij janë të pabazuara.

Po ashtu Kolegji ka konstatuar se bazuar në shkresën e Zëvendësuesit të Zv. Drejtorit në Qendrën e paraburgimit në Prizren me numër reference 04/2022 të datës 14.03.2022 kanë qenë të njoftuar me Instruksionet e Drejtorit për Stafin e Shërbimit Korrektues të Kosovës se: Të gjithë vizitorët zyrtar në Q.P. Prizren. Të gjithë vizitorët duhet të deklarojnë qëllimin e vizitës së tyre, Drejtori/zv. Drejtori duhet të kontaktohen nëse ndonjë person nuk ka kërkuar leje paraprake për të hyrë në burg. Në hyrjen kryesore nga ata do të kërkohet të dorëzojnë ndonjë dokument identifikimi, detajet e tyre do të mbushen në regjistrin e vizitorëve, çfarëdo artikulli që sillen në burg duhet të bastiset. Çdo gjësendi i paautorizuar që vizitori ka (tel mobil, etj.) duhet të merret dhe të vendoset në vend të sigurisë tek hyrja kryesore. Kartela e vizitorit do t'iu dorëzohet para se të lejohen të hyjnë në burg.

Kolegji i Këshillit po ashtu i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht:

Nenit 25 paragrafi 1, 2 dhe 3, i cili ka përcaktuar se: 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e

përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike.

Kolegji i Këshillit, ka vlerësuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit për rastin konkret me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin masës disiplinore vërejtjes me shkrim ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: *"2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilën përcaktohet se: *"2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafin 4, nën paragrafin 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit..... 4.4. si dhe neni 13 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, paragrafi 2 dhe 4 ku përcaktohet se: 1. Kompetent për shqiptimin e masave disiplinore sipas kësaj Rregullore janë: 1.1. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt. 2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt shqipton masën disiplinore të përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit për shkeljet e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 4 të Ligjit. 4. Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 4.1. Shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 4.2. Shkallën e fajësisë; 4.3. Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të Ligjit; 4.4. Përprjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit dhe rrjedhimisht edhe pretendimet ankimore të tij në këtë kontekst janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me objektin e ankesës së ankuesit, ka konstatuar se Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë në rastin konkret Mbikëqyrësi i Qendrës së Paraburgimit në Prizren, në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka arritur të konstatojë saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili thekson se: *"ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit, sepse bazuar në konstatimet e mësipërme janë vërtetuar saktë veprimet e paligjshme të ankuesit lidhur me çështjen në fjalë sipas elaborimit më lartë.*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji i Këshillit, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.962/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit .
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.